



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

2589 /
09.06.2015

Nr.Regj. Themeltar 5734/1301
Date 02.07.2014

Nr. 1207 Vendimi
Date 28.05.2015

V E N D I M

“NE EMER TE REPUBLIKES”

Gjykata Administrative e Apelit e perbere nga gjyqtaret :

KRYESUES : ARTUR MALAJ
ANETARE : LINDITA SINANAJ
ANETARE : ALTINA NASUFI

asistuar nga sekretare gjyqesore Ermelinda Nuraj, ne dhome keshillimi te dates 28.05.2015,
mori ne shqyrtim çeshjen qe u perket paleve :

PADITES : Arjan Tabaku, i biri i Avniut dhe i Fatbardhes, i datelindjes
17.10.1968, lindur dhe banues ne lagjen “30 Vjetori”, Berat

TE PADITUR : 1. Drejtori Rajonale Tatimore Berat (DRT)
2. Drejtoria e Apelit Tatimor Tirane (DAT)

OBJEKTI : Shfuqizimin e Vendimit Njoftim per Vleresim Tatimor Nr. 2650,
dt. 25.07.2013 e te paditurit, DRT Berat.
Shfuqizimin e Vendimin nr. 13326/2 prot., dt. 21.11.2012 i DAT
Tirane.
Pezullimin e Aktit administrative.

BAZA LIGJORE : Neni 324 dhe vijues te K.Pr.Civile; nenet 18/b, 115/a, 116/c, 117, 137 te K.Pr.Administrative; nenet 21, 38, 56, 57, 59 dhe 109/2 te ligji nr.9920, dt.19.05.2008 “Per Procedurat Tatimore ne Republikën e Shqiperise”; Vendimt nr.96, dt. 17.02.2010 i Keshillit te Ministrave; neni 13 i ligjit 7697 dt. 07.04.1993, neni 6 dhe 13 te KEDNJ dhe neni 42 i K.Shqiperise.

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Berat me vendimin Nr. 285, dt. 12.03.2013, ka vendosur:

- Pranimin e padise se paditesit.
- Shfuqizimin e Njoftimi Vlersimi per Detyrim Tatimor nr.2650, dt 25.07.2012 te Drejtorise Rajonale Tatimore Berat dhe te vendimit nr. 13326/2, dt. 21.11.2012 te Drejtorise se Apelit Tatimor Tirane.
- Pezullimin e Akteve Administrative te cituar me siper deri ne perfundim te shqyrtimit Gjyqesor te ceshtjes.
- Shpenzimet gjyqesore ne masen 52 000 leke ne ngarkim te te paditurit.

Kunder vendimit Nr. 285, dt. 12.03.2013, te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Berat, ka paraqitur ankim pala e paditur, DRT Berat, qe kerkon ndryshimin e vendimit, duke parashtruar keto shkaqe:

- Nisur nga urdheri i punes i nxjerr nga DRT Berat, nr. 1640/1 prot., dt.19.07.2012, grupi i punes ka kryer nje kontroll mbi subjektin “Armand Buzi” me Nipt.K93101003L, me aktivitet Furre Buke ne lagj. 30 Vjetori, i cili kishte aplikuar per cregjistrim ne QKR me dt.29.06.2012 (Praktika e cregjistrimit kerkone edhe verifikimin ne terren ne vendin e biznesit per te konstatuar qe subjekti aplikues per cregjistrim nuk ushtron me aktivitetm, por nese ne te njejtin vendbiznesi ushtron aktivitet nje tjeter tatimpagues dhe verehen shkelje te ligjit, inspektorët e verifikimit ne terrenit marrin masat perkates ne perputhje me legjislacionin ne fuqi).

- Nga ky kontroll u mbajt nje Akt-Konstatim me nr.0289627 ne te cilin eshte cituar se: “Subjekti “Armand Buzi” me adres ne Lgj. “30 Vjetori” nuk ushtron aktivite ne kete vend biznesi ne momentin e kontrollit. Ne kete vendbiznes ushtronte aktivitet subjekti “Arjan Tabaku” me nipt L23102004S i regjistruar me dt.02.07.2012. Ne momentin e kontrollit u gjete duke punuar Z.Bujar Buzi. Kontrolli u krye ne oren 09:10”.
- Bazuar ne te dhenat e sistemit informatik te organit tatimor dhe te QKR-se rezulton se tatimpaguesi Arjan Tabaku eshte regjistruar prane QKR-se me dt.02.07.2012 me aktivitet Furre Buke ne lagjen “30 Vjetori”, Pallat 5 katesh, kati i pare, Nipt L23102004S, ne te njejten vendbiznesi sipas te dhenave te QKR-se, ku me pare ka ushtruar aktivitet Armand Buzi me Nipt K931010031. Kontrolli mbi kete subjekt eshte bere ne dt. 19.07.2012. Nga ky akt-konstatim eshte perpiluar edhe Proces-Verbali i gjobes prej 50.000 (Pesedhjete mije leke) ne baze te Ligjit nr.9920, dt.02.09.2008 “Per procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise” i ndryshuar.
- Subjekti “Arjan Tabaku” ne po ate dite (dt. 19.07.2012) qe eshte ushtruar kontrolli nga ana e Inspektorve te DRT Berat, ka bere edhe regjistrimin e Z.Bujar Buzi, qe u gjende ne pune ne momentin e kontrollit. Kjo vertetohet si nga Deklarimi i formularit E-SIG 027/a (Pasqyra e te punesuarve per here te pare, atyre rishtaz, si dhe te larguarve), si edhe nga formulari E-SIG 025/a “Listpagesa e kontributeve per sigurimet shoqerore dhe shendetesore dhe tatimit mbi pagen” i printuar nga sistemi informatik i Drejtons Tatimore, ku rezulton se tatimpaguesi Arjan Tabaku ka deklaruar ne dt.22.10.2012 per muajin komk 2012, punonjes te aktivitetit te biznesit te tij punonjesin Bujar Buzi per 26 dite pune me page bruto 21.000 (Njezete e nje mije leke). Ky deklarim i tatimpaguesit i dt.22.10.2012 (Pas dt. 19.07.2012 te kryerjes se kontrollit) verteton se Proces -Verbali i Gjobes eshte i drejt dhe i bazuar ne ligj.
- Shtetasi Bujar Buzi, ne momentin e kontrollit nuk figuronte i deklaruar si punonjes prane subjektit Arjan Tabaku, por pas perfundimit te kontrollit prej inspektorve tane, eshte bere rregjistrimi elektronik i shtetasit Bujar Buzi si punonjes ne subjektin e Arjan Tabakut. (Deklarimi eshte bere ne dt.19.07.2012) Kjo vertetohet prej formularit te ndryshimit te fuqise puntore, si dhe prej Formularit E-SIG 025/a “Listpagesa e

kontributeve per sigurimet shoqerore dhe shendetesore dhe tatimin mbi pagen”, ku rezulton se tatimpaguesi Arjan Tabaku ka deklaruar ne dt.22.10.2012 per muajin korrik 2012, punonjes te aktivitetit te biznesit te tij punonjesin Bujar Buzi per 26 dite pune me page bruto 21.000 (Njezete e nje mije leke).

- Sqarojme se Akt-Kostatimi eshte dokument zyrtar ne te cilin nuk mund te shprehet ne menyre te specifikuar puna e nje personi te padeklarua prane nje subjekti, por ne lidhje me punen qe po kryente Z. Bujar Buzi jane pyetur dhe kane dhene deshmin e tyre ne seancat gjyqesore, inspektorët qe kane kryer kontrollin dhe kane perpiluar Akt-Kostatim, ku e kane gjetur Z.Bujar Buzi duke punuar (me perparese, duart me mjell etj).
- Nododhe qe ne rastet e kontrolleve te kryera nga ana e mspektorve tane ne biznese, drejtuesit e ketyre te fundit mund te mos jene prezent ne vendin e tyre te punes, por kjo sdo te thote (dhe s’perben shkelje ligjore) qe inspektorët duhet te presin drejtuesin e biznesit per te proceduar nese kostatojne shkelje te ligjit, si ne rastin konkret ku u konstatua nje puntor i pa deklamar ne organet tatimore.
- Nga ana e pales se paditur DAT Tirane eshte verifikuar formulari E-sig 025/a “Listpagesa e kontnbutëve per sigurimet shoqerore e shendetesore dhe tatimin mbi pagen” i printura nga sistemi informatik, te tatimpaguesit Arjan Tabaku, ku rezultoi se ky i fundit ka deklaruar ne dt.22/10/2012 per muajin Korrik, si punonjes ne aktivitetin e tij Z.Bujar Buzi, i punesuar per 26 dite dhe me page bruto 21.000 leke, cka verteton se Proces Verbali I Gjobes eshte i drejte dhe se peretendimet e tatimpaguesit ne kerkesen per apelim nuk qendrojne. Drejtoria e Apelimt Tatimor thekson se tatimpaguesi ne kundershtrim me cfare shkruan ne kerkesen per apelim, ka deklaruar pas dates se kontrollit, punonjes se aktivitetit te tij Z.Bujar Buzi, prandaj gjoba e vendosur per mosdeklarim punonjesi eshte e drejte dhe e bazuar ne ligj.

Gjykata e Apelit Vlore me vendimin Nr. 614, dt. 08.04.2014, ka vendosur:

- Shpalljen e moskompetences lendore per shqyrtimin e ceshtjes civile nr. 1942 regjistri, date 23.04.2013 rregjistrimi.
- Dergimin e akteve gjykates kompetente, Gjykates se Apelit Administrativ Tirane.

GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Pasi degjoi relatimin e gjyqtarit Artur Malaj ne dhome keshillimi:

V E R E N

Rrethanat e faktit :

Paditesi Arjan Tabaku eshte person fizik qe ushtron aktivitet tregtar me objekt: "Prodhim Buke", ne lagjen "30 Vjetori" te qytetit Berat. Ai eshte rregjistruar si i tille ne daten 02.07.2012, date ne te cilen eshte pajisur me Certifikaten e Regjistrimit nga Qendra Kombetare e Regjistrimit, ne te cilen i eshte dhene numeri i identifikimit L23102004S, si person i tatueshem. Kete rregjistrim ai e ka bere pasi ka blere nga i afermi i tij, Armando Buzi ½ pjese te nje furri buke ne lagjen "30 Vjetori" te Qytetit te Beratit, pjese kjo qe ishte e gjithe pjesa e tij takuese. Pjesa tjeter po ½ eshte ne pronesi te dajos tjeter, Bujar Buzi.

Ne gjykim ka rezultuar e provuar gjithashtu se, aktivitetin private ne kete objekt e kishte ushtruar vetem Armand Buzi dhe pasi e ka shitur pjesen e tij e ka mbyllur aktivitetin.

Ne kete objekt ne daten 19.07.2012 nga ana e inspektoreve te DRT, Berat eshte ushtruar kontroll dhe per kete kontroll eshte mbajtur Akti i Konstatimit dhe Procesverbal per vendosjen e gjobes. Ne daten 25.07.2012 eshte nxjere Njoftim per Vleresim Tatimor.

Drejtoria Rajonale e Tatimeve Berat, me aktin administrativ "Njoftim Vleresim Per Detyrimet Tatimore nr.2650 prot., date 25.07.2012, detyrojne personin fizik Arjan Tabaku te paguaje gjobe ne shumen 50.000 leke, ne baze te nenit 119 te ligjit 9920, date 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise", me arsyetimin e mos deklarimit te fuqise punetore.

Brenda afatit ligjor paditesi ka bere ankim administrativ ne Drejtorine e Pergjithshme te Tatimeve ne Tirane. Me vendimin nr.13326/1 Prot., date 21.11.2012, Drejtoria e Apelimit Tatimor, mbi bazen e ankimit te subjektit Arjan Tabaku ka vendosur: "Lenien ne fuqi te gjobes ne shumen 50.000 leke te aktit administrativ Njoftim Vleresimit per Detyrimet Tatimore

nr.2650, date 25.07.2012, per shumen 50.000 leke, te Drejtorise Rajonale Tatimore Berat, per mosdeklarim punonjesi ne organin tatimor”.

Pretendimet e pales paditese :

Paditesi, ka pretenduar se kishte nxjere licencen per ushtrimin e aktivitetit, por nuk kishte filluar pune, pasi po beheshin meremetime te objektit qe kishte ne pronesi 1/2 e tij. Paditesi ka pretenduar se personi, i cili eshte konsideruar si i punesuar pa deklarim eshte bashkepronari tjetet i prones “Furre Buke” dhe njeheresh i afermi i tij dhe nuk ka qene i punesuar per as nje moment ne kete aktivitet. Gjithashtu, paditesi ka pretenduar se aktet e mesiperme per gjobitjen jane marre ne kundersizim me faktin dhe ne interpretim te gabuar te ligjit ne raporte me te.

Pretendimet e pales se paditur :

Pala e paditur pretendon se padia e paditesit duhet rrezuar pasi eshte e pa bazuar ne ligje dhe ne prova, pasi paditesi eshte person fizike dhe ushtron aktivitetin privat ne fushen e prodhimit te bukes ne qytetin e Beratit. Ne ambjentin e tij eshte gjetur duke punuar shtetasi Bujar Buzi dhe subjekti nuk e kishte deklaruar kete te punesuar ne organet tatimore ne perputhje me ligjin. Gjoha e dates 19.07.2012 eshte vendosur bazuar ne Proces Verbalin e konstatimit te shkeljes po te kesaj date dhe eshte ne perputhje me nenin 119 te ligjit 9920, date 19.05.2008 “Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise”.

Vleresimi i Gjykates se Rrethit Gjyqesor Berat :

Gjykata ka cmuar se “Njoftim Vleresimi per Detyrimet Tatimore nr.2650 prot., date 25.07.2012 mbeshtetet ne Proces-Verbal Gjoha nr.0071094, date 19.07.2012, me te cilin eshte vendosur denimi i personit fizik, Arjan Tabaku me gjobe ne shumen 50.000 leke ne baze te nenit 119 te ligjit nr.9920, date 19.05.2008 “Per Procedurat Tatimore ne RSH”, vijne ne kundersizim me ligjin, tregojne rrethana te paverteta dhe cenojne interesat ekonomike te paditesit ne menyre te paligjeshme.

Se pari: Shtetasi Bujar Buzi nuk eshte punonjes i personit Fizik Arjan Tabaku, por eshte bashkepronar i godines ku ushtron aktivitetin ankuesi, vertetuar me vertetimin nga dokumente

hipotekore date 11.06.2012, ku vertetohet se paditesi Arjan Tabaku dhe Bujar Buzi jane bashkepronare te pasurise me nr. 15/128-N10.

Se dyti: Inspektoret ne akt- konstatimin date 19.07.2012 nuk kane saktësuar cfare pune po kryente shtetasi Bujar Buzi ne objektin ne te cilin ata kane ushtruar kontrollin ne fjale.

Se treti: Kontrolli eshte bere ne mungese te ankuesit Arjan Tabaku, fakt ky qe eshte provuar nga permbajtja e akt konstatimit date 19.07.2012, ne te cilin nuk permendet fakti nese paditesi ka qene prezent apo ne mungese. Vetem shenimi ne Rubriken Tatimpaguesi: "Refuzon firmen", nuk mund te merret i mireqene se ankuesi ka qene prezent pasi, ne kete akt nuk eshte shenuar dokumenti i identifikimit dhe numri i dokumentit te identifikimit.

Se katerti: Nga inspektoret e DRT nuk eshte kryer asnje kontroll apo verifikim i metejshem per te konstatuar dhe verifikuar rezultatet e kontrollit, ne shkelje te nenit 60 te Ligjit nr. 9920, date 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne RSH", pasi nuk i kane kerkuar informacion tatimpaguesit per aktivitetin ekonomik dhe operacionet financiare me te tretet.

Gjykata ka cmuar se grupi i kontrollit, ne shkelje te neneve 80, 81 e 83 te ligjit nr. 9920, date 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne RSH", nuk i ka derguar me poste tatimpaguesit kopje te raport kontrollit, per t'i dhene mundesi tatimpaguesit te kundërshtonte rezultatet e kontrollit dhe te paraqiste prova qe te vertetonte se shtetasi Bujar Buzi nuk eshte punonjes i tatimpaguesit. Gjykata ka cmuar se pala e paditur ka zhvilluar nje procedim administrativ jo te rregullt e ligjor. Mohimi i te drejtes per t'u degjuar eshte shkak themelor qe i ben keto akte administrative te pavlefshem.

Vleresimi i Gjykates Administrative te Apelit :

Gjykata Administrative e Apelit, nisur nga provat dhe faktet e administruara ne dosjen gjyqesore, cmon se vendimi i mesiperme i Gjykates se Rrethit Gjyqesor Berat eshte i pabazuar ne prova e ligj dhe si rrjedhoje duhet te ndryshohet:

Referuar Akt-Konstatim me nr.0289627 , rezulton se: "Subjekti "Armand Buzi" me adres ne Lgj. "30 Vjetori" nuk ushtron aktivite ne kete vend biznesi ne momentin e kontrollit. Ne kete vendbiznes ushtronte aktivitet subjekti "Arjan Tabaku" me nipt L23102004S i regjistruar me

dt.02.07.2012. Ne momentin e kontrollit u gjet duke punuar Z.Bujar Buzi. Kontrolli u krye ne oren 09:10”.

Referuar ne te dhenat e sistemit informatik te organit tatimor dhe te QKR-se rezulton se tatimpaguesi Arjan Tabaku eshte regjistruar prane QKR-se me dt.02.07.2012 me aktivitet Furre Buke ne lagjen “30 Vjetori”, Pallat 5 katesh, kati i pare, Nipt L23102004S, ne te njejten vendbiznesi sipas te dhenave te QKR-se, ku me pare ka ushtruar aktivitet Armand Buzi me Nipt K931010031. Kontrolli mbi kete subjekt eshte bere ne dt. 19.07.2012. Nga ky akt-konstatim eshte perpiluar edhe Proces-Verbali i gjobes prej 50.000 (Pesedhete mije leke) ne baze te Ligjit nr.9920, dt.02.09.2008 “Per procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise” i ndryshuar.

Rezulton se subjekti “Arjan Tabaku” ne po ate dite (dt. 19.07.2012) qe eshte ushtruar kontrolli nga ana e Inspektorve te DRT Berat, ka bere edhe regjistrimin e Z.Bujar Buzi, qe u gjende ne pune ne momentin e kontrollit. Kjo vertetohet si nga Deklarimi i formularit E-SIG 027/a (Pasqyra e te punesuarve per here te pare, atyre rishtaz, si dhe te larguarve), si edhe nga formulari E-SIG 025/a “Listpagesa e kontributeve per sigurimet shoqerore dhe shendetesore dhe tatimit mbi pagen” i printuar nga sistemi informatik i Drejtons Tatimore, ku rezulton se tatimpaguesi Arjan Tabaku ka deklaruar ne dt.22.10.2012 per muajin komk 2012, punonjes te aktivitetit te biznesit te tij punonjesin Bujar Buzi per 26 dite pune me page bruto 21.000 (Njezete e nje mije leke). Ky deklarim i tatimpaguesit i dt.22.10.2012 (Pas dt. 19.07.2012 te kryerjes se kontrollit) verteton se Proces -Verbali i Gjobes eshte i drejt dhe i bazuar ne ligj.

Po keshtu rezulton se shtetasi Bujar Buzi, ne momentin e kontrollit nuk figuronte i deklaruar si punonjes prane subjektit Arjan Tabaku, por pas perfundimit te kontrollit prej inspektorve, eshte bere rregjistrimi elektronik i shtetasit Bujar Buzi si punonjes ne subjektin e Arjan Tabakut. (Deklarimi eshte bere ne dt.19.07.2012) Kjo vertetohet prej formularit te ndryshimit te fuqise puntore, si dhe prej Formularit E-SIG 025/a “Listpagesa e kontributeve per sigurimet shoqerore dhe shendetesore dhe tatimin mbi pagen”, ku rezulton se tatimpaguesi Arjan Tabaku ka deklaruar ne dt.22.10.2012 per muajin korrik 2012, punonjes te aktivitetit te biznesit te tij punonjesin Bujar Buzi per 26 dite pune me page bruto 21.000 (Njezete e nje mije leke).

Ne mbeshtetje te nenit 119 te ligjit nr.9920, date 19.5.2008 “Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise”, punonjesit e administrates tatimore, te autorizuar me shkrim, kryejne

verifikime e kontrole te subjektit (verifikime e kontrole ne terren) lidhur me deklarimin e numrit te punonjesve. Per cdo punonjes te padeklaruar ne organin tatimor, te pakten 48 ore perpara fillimit te punes (perfshire dhe punonjesit e papaguar te familjes se te vetepunesuarit me te cilet ai punon e bashkejeton), pervec detyrimit per pagimin e shumes se kontributeve, si dhe te tatimit te papaguar, subjekti perkates detyrohet te paguaje edhe gjobe si vijon:

- a) Tatimpaguesit me qarkullim vjetor deri ne 8 milione leke, 10.000 leke per cdo te punesuar te padeklaruar.
- b) Tatimpaguesit me qarkullim vjetor mbi 8 milione leke:
 - shkelja e pare per mosdeklarimin e punonjesve, 10.000 leke per cdo te punesuar te padeklaruar;
 - cdo shkelje tjeter pas shkeljes se pare per mosdeklarimin e punonjesve, 20.000 leke per cdo te punesuar te padeklaruar.

Gjykata cmon se Akt-Kostatimi eshte dokument zyrtar ne te cilin nuk mund te shprehet ne menyre te specifikuar puna e nje personi te padeklaruar prane nje subjekti, por ne lidhje me punen qe po kryente Z. Bujar Buzi jane pyetur dhe kane dhene deshmin e tyre ne seancat gjyqesore, inspektoret qe kane kryer kontrollin dhe kane perpiluar Akt-Kostatim, ku e kane gjetur Z.Bujar Buzi duke punuar (me perparese, duart me mjell etj).

Pra rezulton se aktet administrative, Njoftim per Vleresim Tatimor Nr. 2650, dt. 25.07.2013 e te paditurit, DRT Berat, dhe Vendimi nr. 13326/2 prot., dt. 21.11.2012 i DAT Tirane, jane nxjerre ne perputhje me nenin 119 te ligjit nr.9920, date 19.5.2008 "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise.

PER KETO ARSYE

Gjykata Administrative e Apelit, bazuar ne nenin 50/1/ c te Ligjit nr.49/2012 "Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative"

V E N D O S I

- Ndryshimin e Vendimit te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Berat me Nr. 285, dt. 12.03.2013, ne kete menyre:

- Rrezimin e padise se paditesit Arjan Tabaku, si te pabazuar ne ligj dhe ne prova.
- Shpenzimet gjyqesore ne ngarkim te paditesit.
- U shpall, sot me date 28.05.2015 , ne Tirane.

ANETARE
LINDITA SINANAJ
dv

ANETARE
ALTINA NASUFI
dv

KRYESUES
ARTUR MALAJ
dv

Vertetohet njesia me origjinalin

Kancelari
Leonard Strelaj
Strelaj